# Informatat mbi Projektin

| | |
|---|---|
| Emri i Projektit: | "Rinia – Promovuesit e ndryshimeve sociale në nivelin lokal” |
| Vlera e projektit: | Kosto totale e projektit € 8,080.08 |
| Kohëzgjatja: | Filimi: 01/09/2020<br>Përfundimi: 28/02/2021 |
| Organizata implementuese: | Center for Women's Development Organization, CWD |
| Kontaktet e Organizatës: Adresa, e-maili, telefonat. | Cwd.office.mitrovica@gmail.com<br><br>Bojana Vukadinović<br><br>+381653770388 |
| Grupet e synuara: | Të rinjtë (15-29 vjeç) në komunat e Mitrovicës Veriore dhe Zveçan; të rinjtë me eksperiencë të mëparshme të aktivizmit, pjesëtarë të Këshilleve Rinoore Lokale dhe organizatave rinore, gjithashtu të rinjtë që nuk kanë përvojë të vullnetarizmit. |
| Partnerët: | / |
| Territori i synuar/shtrirja gjeografike: | Komunat e Mitrovicës Veriore dhe Zveçan |
| Qëllimi i përgjithshëm: | Qëllimi i përgjithshëm I projektit është fuqizimi i të rinjëve për të marrur pjesë aktivisht në procese të nivelit lokal. Gjithashtu, projekti synon të ngrisë kapacitetet e të rinjëve në krijimin dhe menaxhimin e aktiviteteve, punës ekipore dhe udhëheqjen e iniciativave sociale të që synojnë integrimin social dhe barazinë gjinore në Kosovën veriore. Ndër të tjera, të rinjtë do të analizojnë problem të komunitetit të tyre dhe do të zhvillojnë aktivitete që mund të përmirësojnë gjendjen aktuale. Me këtë rast, të rinjtë përfitojnë aftësi dhe kompetenca për njohjen dhe zgjidhjen e problemve të caktuara të komunitetit që vijnë. Gjithashtu, të rinjtë fuqizohen të lobojnë për zgjedhje të problemve përmes peticioneve dhe iniciativave. |
| Aktivitetet kryesore: | Para fillimit të trajimit, ekipi I projektit do të organizojë takime informative me përfaqësues të OJQ-ve të tjera që merren me rininë.,<br>- Moduli i parë do të njoftojë të rinjtë me involvimin e tyre në vetëqeverisje lokale, cilat janë nivelet e pjesëmarrjes, gjithashtu rëndësia e vullnetarizmit dhe aktivizmit në komunitet. Ky modul parashihet të mbahet në zyrat e Shtëpisë së Europës në Mitrovicën Veriore. Moduli i parë zgjatë dy ditë, si dhe materialet dhe pijet do të ofrohen për pjesëmarrësit. Shpenzimet e udhëtimit do të mbulohen për pjesëmarrësit që vijnë nga Zveçani.<br>- Moduli i dytë do të trajtojë çështjen e tipeve të personalitetit në grupe, puna individuale dhe në ekip si dhe komunikimi efektiv. Moduli do të zgjasë dy ditë dhe do të mbahet në lokacionin e njëjtë. Ky modul parashihet të mbahet 3 javë pas modulit të parë.<br>- Moduli i tretë është moduli më i gjatë pasi përfshinë analiza dhe identifikime të problemve në komunitet, krijimi i iniciativave, përdorimi i mjeteve moderne për planifikimin e aktiviteteve dhe të ngjashme. Për këtë, është planifikuar që ky aktivitet të jetë një trajnim resident, që do të mbahet në një lokacion tjetër në mënyrë që të rinjtë të jenë plotësisht të përqëndruar në identifikimin e problemeve dhe krijimin e mundësive inovative në zgjidhjen e këtyre problemeve. Lokacioni i trajnimit planifikohet të jetë në Brezovicë, si Hotel Sharri gjatë ditëve të vikendit (nga e premtja deri të diellen). Moduli i trettë do të mbahet 3 javë pas modulit të dytë. |

Përkrahur nga: LUXEMBOURG AID & DEVELOPMENT

| | |
|---|---|
| Rezultatet e pritura: | Janë fuqizuar 30 të rinjë (15-29 vjeç) që kanë marrë pjesë në 3 module të trajnimit.<br>Gjithashtu, të rinjtë kanë përfituar njohuri dhe aftësi për marrëdhënie me publikun, njohjen e problemeve të komunitetit dhe puna ekipore në zgjidhjen e këtyre problemeve.<br>Të rinjtë që janë përfshirë direkt në trajnim janë trajnuar të njohin problemet sociale të analizojnë dhe rivlerësojnë në mënyrë kritike mundësitë për veprim.<br>Arritja kryrore e projektit do të jetë aktivizimi i të rinjëve në komunitet duke marrë parasysh faktin se janë shumë pasiv. |